



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR  
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA  
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Njesia Orig: \_\_\_\_\_  
Org./Organiza: \_\_\_\_\_  
Org. Unit: \_\_\_\_\_

Nr. Prot: \_\_\_\_\_  
Prot. No.: 3028-2/18

Nr. ifaqve: \_\_\_\_\_  
Broj. Stranica: -02  
No. pages: \_\_\_\_\_

Data: 14.06.18  
Datum: 14.06.18

Prishtinë / a

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING  
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
Ministry of Local Government Administration

Data: 14.06.2018  
Date: \_\_\_\_\_

organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-VI-	020-587/4		

Për :	Ivan Todosijeviq, Ministër në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Cc:	Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	
Përmes:	Albena Reshitaj, Ministre e MMPH-së Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së	
Nga:	Sabrije Rama , u.d.Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Data: 29.05.2018
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Ministër,  
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

**Vendimi i Kuvendit të Komunës së Suharekës Nr.353-8584, datë 23.02.2018, për caktimin e lokacionit për ndertimin e stadiumit – fushave sportive përcjellëse në parcelën kadastrale nr.P-72116045-01846-1.**

I miratuar me datë:23.02.2018

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 14.05.2018

I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 24.05.2018

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**. Mos pajtueshmëri të aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i
1.	Hyrja e Vendimit	<p>Hyrjes së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Suharekës Nr.353-8584, datë 23.02.2018, për caktimin e lokacionit për ndertimin e stadiumit – fushave sportive përcjellëse në parcelën kadastrale nr.P-72116045-01846-1, i mungon baza ligjore, meqense fare nuk i jeni referuar dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.</p> <p>- Destinimi i parcelës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit – fushave sportive përcjellëse në parcelën kadastrale nr.P-72116045-01846-1, të jetë sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor në fuqi, pasi që nuk lejohet destinim tjetër apo shfrytëzueshmëri tjetër nga ajo që është paraparë me dokumentet e planifikimit hapësinor të nivelit lokal të miratuara sipas Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i propozon MAPL-së që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.